

Bibliotekat e Qytetit të Parisit që japin hua

Mirëserdhët në bibliotekat e Qytetit të Parisit !

Rrjeti i bibliotekave të Qytetit të Parisit përbëhet nga 57 biblioteka të shpërndara në të gjitha lagjet e qytetit ku hyrja është e lirë dhe falas për të gjithë.

Në bibliotekat e Qytetit të Parisit do të gjeni hapësira për pritjen dhe informacionin e publikut, si dhe për zbavitje në sajë të shërbimeve të larmishme : 3,5 milionë dokumente dhe 800 kompjutera në dispozicionin tuaj.

Për disa shërbime është e nevojshme që të rregjistroheni (kur merrni hua dokumente, kur përdorni një kompjuter mbi më shumë se 15 minuta rrjesht, etj) por shumë shërbime të tjera ju ofrohen pa qenë e nevojshme të rregjistroheni (përdorimi i tavolinave të punës, kur merrni pjesë në një shfaqje kulturore, etj.)

Regjistrimi në bibliotekë

Një regjistrim i vetëm ju jep mundësinë të huazoni libra në të gjitha bibliotekat e Qytetit të Parisit.

Regjistrimi është i mundur për të gjithë, të rritur apo fëmijë, Parizienë ose jo, të çdo kombësie qofshin.

Një letërnjoftim mjafton për tu regjistruar : karta kombëtare e identitetit, pasaporta, patentat e shoferit, leja e qendrimit, receipte e dosjes së azilit, çertifikata familjare ose çertifikata e lindjes.

Karta e bibliotekës është e vlefshme një vit duke filluar nga data e regjistrimit. Çdo vit kujtohuni ta rinovoni kartën tuaj duke sjellë një letërnjoftim të vlefshëm dhe kartën e përdoruesit.

Shërbimet

Huazimi i materialeve

Keni në dispozicion mbi 3,5 milionë materiale ; pjesa më e madhe si librat, revistat, BD, tekste të lexuar, metoda për mësimin e gjuhës mund të merren hua falas, përveç CD muzikorë dhe DVD të cilët nevojitin një abonim me pagesë.

Biblioteka dixhitale, lexueset dixhitale dhe tabletat

Nëpërmjet sitit të bibliotekave keni mundësi të përfitonit falas nga biblioteka e librave dixhitalë. Mund të merrni hua nga biblioteka, me të njëjtat kushte si një libër dhe gjatë një periode 3 javore një lexuese dixhitale (tablete). Secila prej tyre përmban rreth 1300 libra në gjuhën frënge por edhe në anglisht, spanjisht, gjermanisht...

Tabletat ju propozohen gjithashtu në kuadrin e aktiviteteve për fëmijë dhe për të rritur.

Mësimi i gjuhës frënge dhe i gjuhëve të tjera

Shumica e bibliotekave propozon metoda të gjuhës ndër të cilat, disa dallohen si « pole të gjuhës » dhe propozojnë metoda për të mësuar gjuhë të larmishme si psh: frëngjishten për të huajt, anglishten, gjermanishten, spanjishten, Bengali, gjuhën egjiptiane, indoneziane, pashto, persishten, rusishten, rumanishten, etj) si dhe libra, revista ose materiale zanore në gjuhë të huaj. Disa biblioteka propozojnë gjithashtu seanca bashkëbisedimi në frëngjisht për të rritur që po mësojnë gjuhën.

Coup2Pouce (Shtysë)

Disa biblioteka propozojnë një shërbim falas për të ndihmuar nxënësit e shkollës fillore dhe të kolegjit në kryerjen e detyrave

Shërbimi falas për EIFI

Në sajë të rrjetit Paris Ëi-Fi, ju keni mundësi të lidheni falas me Internetin pa fije me debit të lartë në të gjitha bibliotekat e Qytetit të Parisit.

800 kompjutera në vetëshërbim

Bibliotekat bashkiake ju venë në dispozicion kompjutera në formë vetëshërbimi. Nëpërmjet tyre mund të lidheni falas dhe me siguri të plotë me Internetin, të konsultoni materiale dixhitale apo të përdorni softë të ndryshme.

➤ Kompjutera 15 minuta (pa regjistrim)

Kompjutera që quhen « kalimthi » përdorimi i të cilëve nuk tejkalon 15 minuta janë në dispozicion pa regjistrim.

➤ Kompjutera 2 orë (me regjistrim)

Kompjuterat mund të përdoren nga antarët e bibliotekës karta e të cilëve është akoma e vlefshme. Kompjuterat « për të Rritur » mund të përdoren që nga moshë 12 vjeç dhe vetëm dy orë në ditë. Kompjuterat « për të Rinj » u rezervohen minoreneve dhe mund të përdoren vetëm një orë në ditë.

Një programacion kulturor i pasur dhe i larmishëm

Bibliotekat e Qytetit të Parisit propozojnë një programacion kulturor të larmishëm për çdo publik, i hapur falas për të gjithë dhe pa regjistrim : shfaqje filmash, takime, koncerte, debate, ekspozita, atelie, Ora e përrallës, klube letrare, lojra video, biblioteka verore, etj.

Për të njohur detajet (vendet, aktivitetet, oraret...) kliko

<http://bibliotheques.paris.fr/agenda.aspx>

Për publikun handikapat

Pjesa më e madhe e bibliotekave është e hapur për handikapatët. Polet për Shurdhët dhe « Lire autrement » janë të pajisur me koleksione dhe shërbime të përshtatshëm dhe me mundësi të përforcuara për tu përqasur.

Për informacione të mëtejshme, kliko <http://meslieux.paris.fr/bibliotheques>

Pyetje të bëra shpesh :

Cilat janë oraret e bibliotekave ?

Vini re, bibliotekat nuk kanë të gjitha të njëjtat orare, informohuni në

<http://meslieux.paris.fr/bibliotheques> !

Çfarë mund të merret hua ?

Regjistrimi ju jep mundësi të merrni hua në të gjitha bibliotekat e Qytetit të Parisit deri në 20 materiale, nga të cilat 5 DVD. Mund të merrni hua gjithashtu tableta për lexim dhe libra dixhitale.

Sa kohë mund t'i mbaj materialet e marra hua ?

Materialet mund të mbahen për 3 javë rrjesht dhe afati mund të zgjatet edhe dy herë të tjera nëqoftëse nuk e keni tejkaluar afatin dhe nëse nuk janë të rezervuar. Mund ta zgjasni afatin nëpërmjet llogarisë tuaj të antarit ose në sportelin e bibliotekës.

Si të informohem nëse një material është në dispozicion ?

Duke verifikuar skedarin e bibliotekave në Internet : <https://bibliotheques.paris>

Ku kthehen materialet e marra hua ?

Materialet e marra hua duhen kthyer në bibliotekën ku i keni marrë.

Për çfarë shërben llogaria e përdoruesit ?


Për të rezervuar, zgjatur afatin e kthimit të një materiali, për të ditur se çfarë ke marrë hua dhe për të njohur datën e kthimit.

Si mund të futem në llogarinë time të përdoruesit ?

Shtypni adresën <https://bibliotheques.paris>

pastaj kliko në:

Faqja që del ju jep mundësinë të identifikoheni lart, djathtas:



« Identifiant » është numri i kartës tuaj (pa spacio dhe pa shenja pikësimi).

Fjalëkalimi është data e lindjes, pa spacio dhe pa shenja pikësimi (p.sh : 16021980).

Nëse më ka kaluar afati i kthimit të librave të marra hua ?

Karta bllokohet për çdo vonesë që tejkalon 7 ditëshin dhe deri në kthimin e librave. Gjoha për vonesë duhet paguar detyrimisht sapo shuma kap vlerën 15€.

- 0,15€ për çdo ditë vonesë dhe për çdo material (për të rriturit)
- 0,07€ për çdo ditë vonesë dhe për çdo material (minorenët) ose pezullim i tërheqjes së librave për dy javë kohë.

Na jepni adresën tuaj e-mail në menyrë që t'ju njoftojmë për datën e kthimit të librave.

Në rast se humb ose dëmtoj një material të marrë hua ?

Materialet e humbura ose të dëmtuara duhen rimbursuar ose zëvendësuar.

Si mund të rezervoni librat ?

Mund të rezervoni deri në 10 libra, cilido qoftë suporti, on line ose në sportel.


Nëqoftëse humb kartën time të antarit ?

Sinjalizoni sa më shpejt humbjen apo vjedhjen e kartës tuaj pranë njëres nga bibliotekat. Do t'ju jepet një kartë e re brenda një afati 15 ditor pas deklaratës tuaj.

Si të lidheni me rrjetin Ëifi ?

Për tu lidhur me rrjetin, seleksiononi rrjetin PARIS_ËI-FI pastaj jepni një adresë e maili.

Si të lidheni me kompjuterat e bibliotekës ?



Identification

Langue Français

Identifiant

Mot de passe

Valider

« Identifiant » është numri i përdoruesit që figuron mbi kartën e bibliotekës.

Fjalëkalimi është data e lindjes, pa spacio dhe pa shenja pikësimi (p.sh : 16021980).

Punonjësit e bibliotekës janë në dispozicionin tuaj për t'ju dhënë përgjigje.